
LAJME TË MIRA NGA

# SUNDIMI I LIGJIT

RAPORTI TREMUJOR NR. 5



TAKIMI I TRETË I BORDIT UDHËHEQËS

AKADEMI TRAJNUESE E TEKNOLOGJIVE INFORMATIKE PËR GJYKATËSIT DHE PROKURORËT

PROPOZIMI I STRATEGJISË SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR KRIMIN KIBERNETIK

TRAJNIM I TRAJNERËVE PËR OFICERËT E PROVËS

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

NËNTOR 2024

KLAUZOLË PËRJASHTIMI:
KY RAPORT ËSHTË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJEGJËSI E VETME E LUDWIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT - INSTITUTI I TË DREJTAVE THEMELORE DHE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E BASHKIMIT EVROPIAN.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



# PARATHËNIE



## Dieter SCHINDLAUER

*Drejtues ekipi, "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit"*

*"Ne shfrytëzojmë këtë botim për të ruajtur një frymë të mirë dhe për të mbështetur një etikë besimi në arsyen e mirë për ndryshim, reformë dhe një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për ta bërë këtë, ne do të tregojmë hapat përpara në mënyrë të tillë që ata të mos humbasin në mesin e zhurmës mbizotëruese të lajmeve zhgënjyese".*

I dashur lexues,

Në raportin e tremujorit tonë të pestë ju sjellim përsëri lajme të mira nga çdo fushë e sundimit të ligjit që mbulon projekti ynë.

Në këtë botim, interneti – me mundësitë e shumta pozitive që ofron por edhe me rreziqet- ka një rol të rëndësishëm. Do e shihni se si ka evoluar propozimi i parë i Strategjisë Nacionale për Krimin Kibernetik, do të lexoni për aftësitë e policëve që po forcohen për të vepruar kundër mashtrimeve online, dhe për atë se si profesionistët e IT-së nëpër gjykata dhe prokurori u njohën me higjienën kibernetike, serverët dhe rrjetet. Këto histori flasin për përpjekjet për të mbizotëruar sfidat e vërteta dhe për të prezantuar sfidat digjitale përmes bashkëpunimit, përmirësimit të vazhdueshëm dhe angazhimit për të arritur sukses.

Në këtë raport i jepet theks edhe trajnimeve, sidomos trajnimit të trajnerëve. Do të shihni se si trajnerët nga institucionet e ndryshme u trajnuan për të organizuar punëtori mbi anti-diskriminimin dhe barazinë dhe për angazhimin që morën për të përdorur aftësitë e tyre nëpër grupe të ndryshme qëllimi kurse oficerët e provës u trajnuan për të rritur përfshirjen e kolegëve të rinj dhe mbështetjen e tyre për mësim efektiv kolegial.

# PARATHËNIE

Edhe ne nga ana jonë raportojmë mbi Takimin e tretë të Bordin tonë Udhëheqës ku u shfaq angazhimi i fuqishëm i partnerëve maqedonas për të bashkëpunuar dhe u konfirmuan edhe një herë pritjet e mëdha që ata kanë nga projekti ynë. E fundit po jo më pak e rëndësishme, do të lexoni intervistën me Udhëheqësen e Komponentit Barbara Ligël në kapitullin ,,Tako ekipin'', ku jepen vështrime mbi punën në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, parandalimin e shkeljeve, dhe përvoja praktike.

Shijoni lajmet e mira!



Ditër Shindlauer
Udhëheqës i Ekipit

# JU PREZANTOJMË:

## TAKIMI I TRETË I BORDIT UDHËHEQËS

Projekti ynë mbajti Takimin e tretë të Bordit Udhëheqës: Forcimi i sundimit të ligjit përmes bashkëpunimit të ngushtë në 17 tetor, 2024. Në këtë takim në fokus ishte prezantimi i rezultateve nga shkurti deri në gusht 2024 dhe hapat që planifikohen për të ardhmen.

## PROPOZIMI I STRATEGJISË NACIONALE TË MAQEDONISË SË VERIUT PËR KRIMIN KIBERNETIK

Prezantimi i Strategjisë së parë Nacionale dhe Planit të Veprimit të Maqedonisë së Veriut për Krimin Kibernetik pas 30 viteve. Kjo ngjarje përbën një hap të rëndësishëm përpara në përpjekjet e vendit për të trajtuar krimin kibernetik.

## TRAJNIM I TRAJNERËVE PËR OFICERËT E PROVËS

Trajnimi i trajnerëve “Forcimi i kapaciteteve për prezantim dhe mësim nga kolegët” përforcoi oficerët e provës me aftësi të reja të rëndësishme për të rritur bashkëpunimin në ekip dhe bashkëpunimin institucional.

# Të flasim pak për...

- Takimi i tretë i Bordit Udhëheqës: Forcimi i sundimit të ligjit përmes bashkëpunimit të ngushtë
- Trajnim rrjetëzimi për profesionistët e IT-së nëpër gjykata dhe zyra prokurorie
- Takim i grupit të punës së ekspertëve ndër-institucionalë për ofrim të kompensimeve nga KPDK
- Propozimi i parë i Strategjisë Nacionale të Maqedonisë së Veriut për Krimin Kibernetik që përpilohet pas 30 vitesh
- Trajnimi forcon oficerët e policisë për të luftuar mashtrimet online me aftësi të avancuara dhe strategji bashkëpunuese
- Teknika të mësimit kolegial dhe mentorimit si motivim për të arritur nivele të larta të profesionalizmit brenda shërbimit të provës
- Program i Trajnimit të Trajnerëve për Anti-diskriminimin dhe Barazinë

# Takimi i tretë i Bordit Udhëheqës

Projekti Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit organizoi Takimin e tretë të Bordit Udhëheqës në 17 tetor, 2024, në hapësirat e Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK). Gjatë këtij takimi u prezantuan rezultatet e arritura nga shkurti deri në gusht 2024 dhe hapat që planifikohen për të ardhmen.

**Tatjana Dimitrovska,** Kryetare e Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit iu dëshiroi mirëseardhjen pjesëmarrësve duke shprehur kënaqësinë për organizimin e këtij takimi si një nga institucionet përfituese nga ky projekt. Ajo theksoi angazhimet e marra për të vazhduar bashkëpunimin me projektin.

**Diter Shindlauer,** Udhëheqës i Ekipit të Projektit, moderoi këtë takim dhe theksoi që qëllimi që synohet me këtë projekt është prodhimi i mënyrave të rezonimit në institucionet përfituese qw do të forcohet dhe do të bëhet më efikas me këtë mbështetje.

**Agnes Taibl**, Drejtore e Projektit nga Instituti i Bolcmanit për të Drejtat Themelore dhe të Drejtat e Njeriut, përgëzoi të gjithë për arritjet e projektit, duke shprehur falenderim për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm. Ajo theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi i ngushtë për tu arritur rezultatet e përbashkëta, duke ndaluar tek arritjet kryesore si miratimi i planeve nacionale të veprimit, zbatimi i rekomandimeve nga misioni recenzues i BE-së, Plani Nacional i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve, dhe përpilimi i sistemit të burimeve njerëzore për KSHPK. Ajo theksoi që këto suksese janë bërë të mundura për shkak të ekspertizës që kanë ekspertët nacionalë po edhe ata ndërkombëtarë dhe dedikimit të vazhdueshëm nga çdo partner i konsorciumit.



**Marzia Palota,** përfaqësuese e Delegacionit të Bashkimit Evropian (DBE), ritheksoi rëndësinë që angazhimet e përbashkëta kanë dhe rolin e rëndësishëm në zbatimin e suksesshëm dhe reformat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut.

**Udhëheqësit e komponenteve prezantuan rezultatet kryesore,** duke dhënë hollësi mbi atë se si projekti ka zbatuar zbatimin e Rekomandimeve nga Recenzentët e BE-së duke forcuar rregullativat e Këshillit Gjyqësor, përgatitjen e raporteve për prokurorët publikë, dhe përgatitjen e sistemit të IT-së nën IPA III. U mbajtën mbi 40 orë të trajnimeve të IT-së, dhe u sigurua ndihmë për Ministrinë e Drejtësisë për menaxhim të Strategjisë së Gjyqësorit 2024-2028.



Iniciativat kryesore lidhur me ndërtimin e kapaciteteve përfshinë punëtori mbi Darknetin, hetimet financiare, anti-korrupsionin, dhe trajnime të specializuara për policinë. Projekti poashtu bëri analizat mbi strategjitë e vendit për terrorizmin dhe krimin e organizuar dhe krimin kibernetik, duke mundësuar kështu bashkëpunim me iniciativa të nisura nga donatorë të tjerë.

Poashtu, projekti bëri shqyrtim të procedurave të KSHPK, përpiloi politika për burimet njerëzore dhe qasjes së përdoruesve, zhvilloi kursin e parë të IACA mbi Shkeljet Organizative, dhe organizoi trajnim komunikimi për institucionet e pavarura.

Fushatat për vetëdije u ndoqën nga 13 000 profesionistë dhe nga opinioni, dhe u përpiluan dokumente strategjike për të drejtat e fëmijëve dhe grave dhe vajzave rome.

Përfaqësuesit nga institucionet partnere nga Republika e Maqedonisë së Veriut shprehën mirënjohjen e tyre për ndihmën që ofron projekti dhe kontributin e madh në fushën e sundimit të ligjit.

Në këtë takim ku morën pjesë 37 përfaqësues nga delegacioni i BE-së, partnerët e konsorciumit, institucionet përfituese dhe ekspertë u nënvizua angazhimi bashkëpunues drejt ndërtimit të një shoqërie më të drejtë dhe më transparente në Maqedoninë e Veriut.






# Duke kapur suksesin:

## Një festim vizual














# Trajnim rrjetëzimi për profesionistët e IT-së nëpër gjykata dhe zyra prokurorie

Ekspertët e projektit nga fusha e IT-së eksploruan mënyrat për të rritur efikasitetin e Zyrave të Prokurorisë Publike (ZPP) dhe Gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Brenda fushës së tyre të ekspertizës, ekspertët propozuan një sërë aktivitetesh gjatë takimeve që mbajtën me personelin e IT-së nga gjykatat dhe prokuroritë. Gjatë këtyre takimeve, u bë e qartë që profesionistëve të IT-së nuk iu jepen mundësi të mjaftueshme për të zhvilluar më tutje aftësitë profesionale. Ekspertët e IT-së propozuan organizimin e disa trajnimeve në bashkëpunim me Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve (Akademia).

Nga një sërë trajnimesh që u propozuan, këto më poshtë u konsideruan si temat më të rëndësishme dhe të nevojshme për personelin e IT-së nëpër gjykata dhe prokurori publike:

- Trajnimi për Vetëdije mbi Higjienën Kibernetike
- Trajnimi për Bazat e Rrjetëzimit
- Trajnimi për Bazat e Virtualizimit
- Trajnimi për Serverët e Uindousit

Trajnimi i parë nga të propozuarit (Trajnimi për Vetëdije mbi Higjienën Kibernetike) u mbajt në Akademi në katër punëtori njëditore, me pjesëmarrje aktive të pesëdhjetë e gjashtë profesionistëve të IT-së nga gjykatat dhe prokuroritë. Këto punëtori u mbajtën në fund të vitit 2023 dhe fillim të 2024.



Raundi i dytë i trajnimeve (Trajnimi për Bazat e Rrjetëzimit) po mbahet në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, për shkak të nevojës së laboratorit kompjuterik. Aktivitetet e organizimit të trajnimeve u ndanë mes Akademisë dhe Projektit.

Në shtator dhe tetor të vitit 2024, grupi i parë i të trajnuarve ndoqi trajnim dyzet orësh, ndarë në dhjetë ditë. Grupi i parë i katërmbedhjetë të trajnuarve përbëhet nga profesionistë të IT-së nga gjykatat themelore, të apelit dhe ato supreme, si dhe personel i IT-së nga zyrat e prokurorisë në Shkup dhe Manastir. Çdo pjesëmarrës mori pjesë në mënyrë aktive gjatë seancave të trajnimit dhe në fund të trajnimit të gjithë u ndanë të kënaqur nga organzimi i trajnimit. Poashtu u pa një interes i madh për pjesëmarrje edhe nëpër trajnime të tjera.




Gjatë këtij trajnimi u bë e qartë që vendimi për të përfshirë përzierje të personelit të IT-së nga gjykata dhe prokurori të ndryshme shkon në avantazh të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit mes tyre. Ata filluan të eksplorojnë mënyra për bashkëpunim të mëtejshëm dhe rritje të efikasitetit të bashkëpverimit mes gjykatave dhe prokurorive. Disa nga mundësitë tashmë u morën parasysh, dhe para përfundimit të trajnimit u nxit të menduarit mbi aktivitete të tjera për të arritur bashkëveprim më të mirë.

# Takimi i grupit ndërinstitucional të punës mbi ndarjen e kompensimeve nga KPMD

Në 26 shtator 2024, u mbajt takim i grupit ndërinstitucional të punës në Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. Në këtë takim të parë të këtij lloji u bënë bashkë gjykatës nga gjykatat civile dhe ata që trajtojnë raste të shkeljeve, avokatë, ekspertë të vendit dhe të jashtëm në fushën e diskriminimit dhe kompensimit, dhe përfaqësues të OJQ-ve që ofrojnë ndihmë juridike pa pagesë në rastet e diskriminimit.

Përmes këtij takimi u synua që të eksplorohen mundësitë e përdorimit të mundësive ekzistuese ligjore për të kompensuar viktimat që kanë kërkuar mbrojtje para KPMD. Informacionet që u ndanë, sidomos nga përspektiva e gjyqësorit, rezultuan si thelbësore dhe siguruan që diskutimi të bazohet në realitetin praktik dhe duke pasur parasysh praktikat e parashtrimit dhe trajtimit të rasteve të diskriminimit.



Gjatë diskutimeve, pjesëmarrësit theksuan pranimin gjithmonë më të madh të kompetencave që kanë organet e barazisë në Evropë për të shqiptuar dënime dhe mungesën e pranimit të ingirencave për të dhënë kompensim. Megjithatë, me praktikat e KPMD u theksuan rastet ku kompensimi i viktimave është mënyra e vetme për të trajtuar situatën. Pjesëmarrësit ranë dakord që ingirencat momentale që ka KPMD, sidomos duke pasur parasysh natyrën këshilluese të opinioneve që shqipton, zgjeron mundësinë për të ofruar rrugë drejt drejtësisë për viktimat e diskriminimit që kërkojnë mbrojtje para këtij organi të barazisë.

Një pjesë e takimit iu dedikua edhe formave alternative të zgjidhjes së konflikteve dhe mënyrave se si organi i barazisë mund të angazhohet në këtë drejtim. Ekspertët ofruan shembuj nga rastet që kanë rezultuar me zgjidhje alternative të konflikteve. Megjithatë, pjesëmarrësit ranë dakord që palët e lëndës duhet të jenë të njohur plotësisht implikacionet që sjell zgjedhja e ndërmjetësimit.

Meqë Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi nuk parasheh dispozita të qarta që do i jepnin KPMD ingirencat për të dhënë kompensime dhe për tu angazhuar në ndërmjetësim, pjesëmarrësit njëzëri u dakorduan që KPMD duhet të ketë kujdes në formulimin e rekomandimeve që jep. **Ata theksuan rëndësinë që ka harmonizimi i këtyre rekomandimeve me kontekstin e vendit dhe sigurimi i zbatimit praktik të tyre.**

Iniciativa e fillimit të dialogut për të dhënë kompensime dhe forcimi i mbrojtjes nga diskriminimi u pranua mirë nga pjesëmarrësit. Vullneti që dëshmuan për të vazhduar këto diskutime vërteton angazhimin që kanë marrë për këtë kauzë.

Sipas përfundimeve që dolën nga kjo ngjarje, një ekspert ndërkombëtar do të mbështesë KPMD për të hartuar udhëzime të brendshme që do të forcojnë mbrojtjen nga diskriminimi duke përpiluar rekomandime adekuate që trajtojnë problemet e caktuara për secilin rast.



# Propozimi i parë i Strategjisë Nacionale të Maqedonisë së Veriut për Krimin Kibernetik që përpilohet pas 30 vitesh

Prezantimi i Propozimit të parë të Strategjisë Nacionale të Maqedonisë së Veriut për Krimin Kibernetik dhe Planit të Veprimit u mbajt të mërkurën, 11 shtator 2024, duke bërë bashkë palët relevante, ekspertët ligjorë dhe përfaqësues të pushtetit. Kjo ngjarje ishte një hap i rëndësishëm përpara në angazhimet që vendi ka marrë për të luftuar krimin kibernetik.

Në këtë takim dhanë prezantime interesante ekspertët kroatë Z. Predrag Pale dhe Mr Renato Grguric, që ndanë njohuritë dhe pikëpamjet e tyre mbi propozim strategjinë dhe planin e veprimit. Strategjia përqëndrohet në disa qëllime kryesore, përfshirë këtu caktimin e një kornize efektive të ligjit penal, duke rritur vetëdijen mbi kontekstin, dhe ndërtimin e aftësive për zbulim të hershëm, parandalim dhe trajtim të shpejtë të krimit kibernetik. Poashtu, strategjia thekson rëndësinë që ka zhvillimi i burimeve njerëzore për të rritur vetëdijen e opinionit dhe qëndrueshmërinë ndaj kërcënimeve kibernetike.



Pjesëmarrësit morën pjesë në diskutime interaktive, duke dhënë informacione të vlefshme dhe informata kthyese për të rritur më tutje cilësinë e planit të veprimit. U prezantuan hapat e detajuara për zbatimin e strategjisë, duke theksuar masat e fuqishme që duhen marrë gjatë viteve në vijim për të forcuar angazhimet për sigurinë kibernetike.

Në fjalën e rastit, Z. **Aleksandar Janev,** Drejtori i Përgjithshëm i Policisë shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Bashkimi Evropian dhe Komponenti 2 i Projektit jep për të rritur kapacitetet e Policisë dhe Ministrisë së Brendshme.

Ai theksoi që pas 30 viteve, kjo iniciativë përbën një angazhim gjithëpërfshirës për të përpiluar një strategji nacionale për të luftuar krimin kibernetik. “Me këtë ngjarje shënohet një hap i rëndësishëm i angazhimeve tona të përbashkëta për të krijuar Strategjinë e parë Nacionale për Krimin Kibernetik dhe Planin e Veprimit, që do të shërbejë si udhërrëfyes për të forcuar qëndrueshmërinë e vendit ndaj këtij kërcënimi që po zhvillohet çdo ditë e më shumë,” tha Janev.

Diskutimet gjatë kësaj ngjarjeje rezultuan si produktive, duke bërë që plani i veprimit të zhvillohet më tutje, dhe duke hapur rrugën për zbatimin e një kornize të fortë nacionale për të trajtuar sfidat e krimit kibernetik që janë gjithmonë në rritje.







# Duke kapur suksesin:

## Një festim vizual












# Trajnimi forcon oficerët e policisë për të luftuar mashtrimet online me aftësi të avancuara dhe strategji bashkëpunuese

Në 3 tetor 2024, në Hotelin Alexander Square në Shkup u bënë bashkë oficerët e policisë për një seancë trajnimi me titull ,,Lufta kundër mashtrimit online: Të kuptuarit e skemave, teknikat hetimore dhe strategjitë e bashkëpunimit." Udhëhequr nga ekspertët Dejvid Grejser, anëtar i EMPACT OFS, dhe Boshtjan Rozman, që të dy inspektorë të lartë të specializuar për raste penale brenda Policisë së Sllovenisë, me këtë trajnim u trajtuan çështjet kritike të mashtrimit online—një kërcënim në rritje në botën bashkëkohore digjitale.

Pjesëmarrësit analizuan gamë të gjerë të taktikave të mashtrimit, përfshirë këtu skemat e mashtrimeve me investime, mashtrimi CEO, kompromentimet e emailit zyrtar, mashtrimet romantike, skemat e rrejshme për mbështetje teknike, dhe mashtrimet me dërgime të mailave. Duke kuptuar se si operojnë dhe si zhvillohen këto skema komplekse, oficerët mund të identifikojnë dhe të reagojnë më mirë ndaj këtyre krimeve kibernetike. Në këtë trajnim u theksuan taktikat bashkëkohore të hetimit, dhe pjesëmarrësve iu mundësua të bëjnë ushtrime praktike që pasqyrojnë skenare nga jeta e përditshme për të forcuar aftësitë për të zbuluar kriminelët që veprojnë në faqet e errëta të internetit.



Oficerët ushtruan teknika të avancuara për zbulim të gjurmëve digjitale që mashtruesit përdorin për të fshehur identitetin, duke rritur kështu efektivitetin e hetimeve. Mbledhja dhe ruajtja e provave elektronike është një çështje tjetër kritike, ku oficerët mësuan se si të identifikojnë dhe të sigurojnë prova digjitale që janë të domosdoshme për të ndërtuar lëndët kundër kriminelëve kibernetikë.

Poashtu, ata eksploruan mënyrat për gjurmim të aktiviteteve ilegale financiare përtej kufijve, nga zbulimi i rrjeteve për transfer ilegal të parave, deri tek ndjekja e transaksioneve të dyshimta dhe zbulimi  i infrastrukturave financiare që mbështesin mashtrimet online. Si temë qendrore ishte gjithmonë bashkëpunimi. Trajnerët theksuan rëndësinë që ka partneriteti mes agjencive që zbatojnë ligjin, institucioneve financiare dhe sektori privat për të shkatërruar rrjetet e krimit kibernetik. Ky trajnim përveç që u ofroi oficerëve aftësitë e nevojshme për të luftuar mashtrimin online, edhe ritheksoi vlerën që ka bashkëpunimi ndërsektorial për mbrojtje të viktimave dhe komuniteteve. Në një kohë kur krimi kibernetik vazhdon të zhvillohet, seancat e specializuara si ky trajnim janë të domosdoshme për të forcuar aftësitë e zbatimit të ligjit dhe për të siguruar një mjedis më të sigurt digjital për të gjithë.



# Teknika të mësimit kolegial dhe mentorimit si motivim për të arritur nivele të larta të profesionalizmit brenda shërbimit të provës

Trajnimi i trajnerëve ,,Forcimi i kapaciteteve për prezantim dhe mësim kolegial" forcoi aftësitë e oficerëve të provës duke shtuar kohezionin mes tyre dhe bashkëpunimin institucional. Duke prezantuar teknika të mësimdhënies dhe mentorimit për të rriturit, pjesëmarrësit panë nga afër mënyrat se si të përshtasin procesin e prezantimit për nevojat që kanë të punësuarit e rinj, duke shënuar hapa përpara në qasjen që shërbimi i provës ka për zhvillim profesional.

Ekspertët ndërkombëtarë me qëndrim të shkurtër të specializuar në fushën e provës nga Kroacia ndanë përvoja praktike nga shërbimi i tyre i provës, duke ofruar shembuj konkretë për mësimin nga kolegët, mentorimin, dhe vendosjen e një kulture të mirë brenda organizatës. Pjesëmarrësit në mënyrë aktive u angazhuan me diskutime dhe ushtrime në grup, dhe shumë nga ta shprehën interesin për të zbatuar strategjitë e sapo mësuara gjatë punës së tyre të përditshme.

Gjatë këtij trajnimi fokusi ishte në fusha thelbësore si informacioni efektiv kthyes, caktimi i qëllimeve, dhe empatia, aftësimi i oficerëve të provës për të mbështetur më mirë kolegët dhe për të rritur dinamikën brenda vendit të punës.



Ekspertët ndërkombëtarë ndanë njohuri mbi përpilimin e programeve individuale për trajtim për të akuzuarit dhe menaxhimin e strukturuar të lëndëve, gjë që frymëzoi pjesëmarrësit që të evitojnë punën e lëndëve të grumbulluara në grupe duke preferuar më shumë qasjet individuale.

Oficerët e provës shfaqën interes sidomos për modelin e Kroacisë dhe theksin që ata vendosin mbi komunikimin e rregullt, strukturat fleksibile të kierarkisë, dhe këmbimin e dyanshëm të informacionit, duke nxitur ide mbi atë se si mund të përmirësojnë veprimin e shërbimit të tyre.
Pjesëmarrësit panë nevojën për të futur në përdorim mënyra të ndarjes së informacionit me kolegët në formë më të lehtë për tu qasur dhe forcimin e marrëdhënieve ndërpersonale mes oficerëve të provës. Pjesëmarrësit shprehën mirënjohjen për ekspertizën që trajnerët ndanë, duke përshkruar seancat jo vetëm si edukative por edhe si frymëzuese.

**Vesna Zeliç Ferençiç,** njëra nga trajneret dhe udhëheqëse e shërbimit për zhvillim të sistemit të provës në Ministrinë e Drejtësisë, Administratës Publike dhe Transformimit Digjital në Republikën e Kroacisë sheh ndërtimin e kapaciteteve si proces reciprok:



> „Edukimi është gjithmonë një mundësi mësimi jo vetëm për pjesëmarrësit por edhe për trajnerët. Trajnerët në secilin grup trajnimi japin maksimumin dhe përpiqen të krijojnë atmosferë të mirë pune, por ajo magji që ndodhi mes trajnerëve dhe grupit gjatë këtij trajnimi është një fenomen i rrallë. Është nder dhe frymëzim të marrësh pjesë në këtë lloj trajnimi me oficerë profesionistë dhe të motivuar të provës modestia e të cilëve dhe vullneti për të mësuar na nxit që të bëhemi trajnerë më të mirë.“

Seancat interaktive u mundësuan oficerëve të provës të mendojnë mbi kulturën organizative që ka shërbimi i provës në Maqedoninë e Veriut, duke identifikuar fushat ku duhen përmirësime dhe duke propozuar ide, si për shembull emërimi i udhëheqësve të zyrave të provës për të forcuar lidershipin. Ushtrimet praktike theksuan rëndësinë që kanë metodat e përshtatshme të prezantimit, dhe pjesëmarrësit me vullnet të madh pranuan konceptet e reja të mentorimit si pjesë e praktikave të tyre të së ardhmes. Pyetësorët e plotësuar zbuluan që formati dhe përmbajtja e trajnimit kishte rezultuar e suksesshme, sidomos atmosfera e hapur dhe udhëzimet praktike nga trajnerët. Të frymëzuar nga këto instrumente të reja, oficerët e provës u ndanë nga ky trajnim me dëshirën për të krijuar mjedise mbështetëse dhe efektive të ekipit dhe me dëshirën për të inkorporuar mbështetje të strukturar dhe individuale për ekipet e tyre.



# Programi i Trajnimit të Trajnerëve për Anti-diskriminim dhe Barazi

Në 4 tetor 2024, që ishte dita e fundit e programit të Trajnimit 12 ditor të Trajnerëve (TT) mbi ,,Artin e trajnimit dhe facilitimit me pjesëmarrje për parandalim të diskriminimit dhe promovim të barazisë'', u shënua një moment i rëndësishëm për 18 trajnerët nga tri institucione thelbësore – KPMD, Zyra e Avokatit të Popullit, dhe Ministria e Punës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

Organizuar nga një ekip me ekspertë ligjorë dhe facilitatorë për pjesëmarrje nga Komponenti 4, në këtë trajnim pjesëmarrësve iu mundësua fitimi i njohurive të rëndësishme, materiale, dhe aftësi për të rritur vetëdijen, për të nxitur krijimin e aleatëve, dhe për të filluar zbatimin e barazisë mes një game të gjerë të grupeve të qëllimit.

Programi TT ndoqi standardet e edukimit mbi të drejtat e njriut, me theks të veçantë në mësimin praktik dhe mësimin me pjesëmarrje për të rritur në maksimum angazhimin, refleksivitetin dhe marrjen e përgjegjësive.





Grupi i TT përfundoi programin i përgatitur mirë dhe me motivim të lartë për të zbatuar trajnime të ardhshme në mënyrë më përfshirëse se më parë. Hapi i radhës do të jetë zbatimi i aftësive të marra për auditore të ndryshme – nga zyrtarët e administratës shtetërore dhe praktikues të ligjit deri tek edukatorët dhe oficerët e policisë.

> “Do të organizoj një ngjarje duke përdorur ushtrimet dhe detyrat nga trajnimi i trajnerëve!”
>
> “Më pëlqyen ushtrimet interaktive, qasja e trajnerëve, dhe mjedisi i respektit të përbashkët, besimit, dhe kreativitetit që u krijuan.”

Trajnerët raportuan rritje mjaft të madhe profesionale dhe personale, sidomos për shkak të qasjes së mirëorganizuar dhe të mirëkonceptuar që ka programi. Me qasje në një bibliotekë të madhe online të materialeve, ata mund t’iu referohen lehtë resurseve dhe metodave kur t’iu duhet që të planifikojnë seancat për grupe të ndryshme që do të ndjekin trajnimet.

Duke reflektuar për informacionin kthyes që morën, pjesëmarrësit shprehën mirënjohje për fokusin e programit si në dimensionin ligjor të anti-diskriminimit ashtu edhe në punën introspektive për të shqyrtuar paragjykimet dhe qëndrimet personale. Nxitja e diskutimeve mbi anti-diskriminimin dhe të drejtat e njeriut përmes metodave të mësimit me përvojë dhe me pjesëmarrje rezultoi si përvoja më përfituese nga grupi, që u shprehën:

> “Po marr me vete një sërë aktivitetesh, materialesh dhe metodash për një qasje interaktive që inkurajon angazhimin dhe përfshirjen e pjesëmarrësve.”
>
> “Më pëIqyen sidomos aktivitetet e mirë strukturuara me një qëllim të qartë, si për rritje të vetëdijes për ndonjë temë ashtu edhe teknikat për forcim të aftësive për t’iu kundërvënë paragjykimeve dhe gjuhës së urrejtjes.”



# LIEGL Barbara

*INTERVISTA*

# NJIHUNI ME EKIPIN

**UDHËHEQËSE KOMPONENTI**

# SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT E NJERIUT JANË TË PANDASHME

***Njihuni me ekipin: Kapitulli i intervistës ju prezanton me anëtarët e ekipit të projektit „Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit".***

**Ms. Barbara Liegl,** Udhëheqëse e Komponentit 4, është eksperte me përvojë të gjatë në fushën e anti-diskriminimit, diversitetit dhe të drejtat e njeriut. Ka diplomuar për shkenca politike dhe gjuhë angleze në Universitetin e Vienës dhe ka vazhduar studimet e mëtejshme në Institutin e Studimeve të Avancuara, Vienë. Ka udhëhequr programe të rëndësishme mbi azilin, migrimin dhe mos-diskriminimin në Institutin Ludvig Bolcman për të Drejta Themelore dhe të Drejta të Njeriut. Ka shërbyer si drejtore ekzekutive e OJQ-së ZARA – Zivilcourage und Anti-Rassismus-Arbeit, me seli në Vienë që lufton kundër racizmit dhe urrejtjes online. Barbara ka mbështetur iniciativat për barazi dhe të drejta të pakicave në Kroaci dhe Serbi dhe ka udhëhequr ekipe diverse për projekte të shumta të BE-së, duke bashkëpunuar me institucionet publike dhe palët relevante për të avancuar barazinë dhe sundimin e ligjit.

**Si udhëheqëse e Komponentit 4 që ka në fokus mbrojtjen e të drejtave themelore dhe forcimin e marrjes së masave alternative të paraburgimit në Maqedoninë e Veriut, si do e kishit përkufizuar ju sundimin e ligjit?**

Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut janë të pandashme. Sundimi i ligjit bën të mundur zbatimin e lirive dhe të drejtave të caktuara brenda regjimit të të drejtave të njeriut. Pa sundim ligji, të drejtat e njeriut mund të shkilen pa pasoja, dhe pa të drejta të njeriut, ligjet mund të diskriminojnë. Të drejtat e njeriut garantojnë standarde dhe rregulla që duhen marrë parasysh nga pushteti ligjvënës. Ligjet që ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, fesë apo besimit, racës, kufizimit, moshës apo statusit shoqëror jo vetëm që mbrojnë të drejtat e njeriut, por përbëjnë edhe angazhim për të zbatuar parimet e sundimit të ligjit. Këto ligje garantojnë që individët me prapavija të ndryshme dhe nga situata të ndryshme mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për trajtim të barabartë në fushat siç janë punësimi, vendbanimi apo arsimimi. Të drejtat e njeriut sigurojnë që dallimet respektohen dhe mbrohen nga sistemi ligjor, ato promovojnë gjithëpërfshirje dhe mbështesin masat që akomodojnë dallimet.

Parimet e sundimit të ligjit mbështesin zbatimin e këtyre të drejtave: personave që iu shkilen të drejtat e njeriut mund të kërkojnë drejtësinë (p.sh. duke u drejtuar tek avokatët e popullit, tek ndonjë bord për barazi apo në ndonjë gjykatë) dhe kanë të drejtë të masave efektive të trajtimit. Situata e tyre mund të zgjidhet dhe shkeljet e atij lloji mund të parandalohen në të ardhmen.

**Cilat janë sfidat apo gjërat pozitive që keni hasur gjatë udhëheqjes së Komponentit 4 të këtij projekti që kanë bërë të ndryshoni qasjen tuaj ndaj mbështetjes së të drejtave themelore?**

Në thelb të mbrojtjes së të drejtave të njeriut është dinjiteti i qenieve njerëzore. Në institucionet e Maqedonisë së Veriut, nëpër komunitete apo edhe vetë qytetarët thonë që janë ‘‘në rrugë të të mësuarit’’ mbi ‘‘të drejtat e njeriut’’. Një pjesëmarrës në Forumin e parë të Drejtave të Njeriut tha (21.03.2024), “të drejtat e njeriut vazhdojnë të jenë një temë e re; dikush mëson më shpejt nga dikush tjetër”. Aktivitetet e projektit kanë vënë në pah mungesën e vetëdijes për mbrojtje të dinjitetit të fëmijëve, p.sh. një vajzë 13 vjeçare rome që i shkilet e drejta për arsim dhe shëndet cilësor si rezultat i mungesës së certifikatës së lindjes, apo djalë në shkolle fillore që bullizohet nga shoket që nuk merr asnjë mbështetje nga institucionet që e kanë për detyrë ta mbështesin, dhe bëhet viktimë e riviktimizimit.



Një anëtar i ekipit tim të mrekullueshëm të ekspertëve mbështeti fëmijët dhe familjet e tyre për të bërë ankesa në çdo institucion relevant – si tek Avokati i Popullit, Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit. Është mjaft inkurajuese kur shohim se si këto institucione bëjnë inspektime nëpër organet e duhura që të fillojnë të merren masa siç janë mbajtja e takimeve dhe punëtorive me fëmijët, prindërit, dhe mësimdhënësit për të ndaluar bullizimin.

**Komponenti 4 ka hapur Forumin vjetor për të Drejtat e Njeriut, një ngjarje që duhet të organizohet çdo vit. Si kontribuon ky forum në avancimin e anti-diskriminimit dhe të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut?**

Pa dallim se a jeni një nxënës, ndonjë person që punon për OJQ-të, një polic, deputet, kushdo mund të bëhet mbrojtës i të drejtave të njeriut. Forumi për të Drejtat e Njeriut rrit vetëdijen tek përfaqësuesit e institucioneve publike mbi obligimet që ata kanë si dhe mbi potencialin për të mbrojtur dhe për të promovuar të drejtat e njeriut. Ky forum ofron hapësirë joformale për të identifikuar sfidat që hasen gjatë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe shembujt e praktikave të mira se si funksionon mbrojtja e të drejtave të njeriut. Pjesëmarrësit nga institucionet e ndryshme mund të këmbejnë përvojat, mund të mësojnë nga njëri tjetri dhe të zhvillojnë kulturë bashkëpunimi, që ofron qasje strategjike dhe të forcuar për të pasur politika dhe masa më efektive jo vetëm për mbrojtje të qytetarëve nga diskriminimi dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut por edhe për të parandaluar këto dukuri. Masat parandaluese ruajnë dinjitetin e njeriut, ulin ekspozimin ndaj rrezikut dhe çojnë mesazhin e fortë që ata që shkelin të drejtat e njeriut duhet të mbajnë përgjegjësi.

**Forumi i të Drejtave të Njeriut ndjek metodën e Kafesë Botërore—pse është kjo një qasje e rëndësishme për të mundësuar dialog mbi të drejtat e njeriut? Cilat janë vlerat e veçanta që kjo qasje sjell për diskutimet në këtë fushë?**

Forumi i parë i të Drejtave të Njeriut u fokusua në identifikimin e sfidave dhe praktikave të mira brenda sistemit për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe në përpilimin e rekomandimeve se si mund të forcohet sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Kafeja Botërore është metodë me participim që mundëson këmbime dinamike mes pjesëmarrësve, të cilët ndajnë ide të rëndësishme dhe dëshmojnë vullnetin e madh që kanë për të bashkëpunuar me qëllim që të formësojnë drejtë rezultatet e takimit. Pjesëmarrësit ftohen të dokumentojnë idetë apo rezultatet e tjera që dalin nga bisedat e tyre, gjë që mbështet nxitjen e bisedave të rëndësishme. Kjo metodë garanton që pjesëmarrësit ndajnë idetë e tyre dhe që këto ide dëgjohen dhe merren me seriozitet për të zhvilluar më tutje sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut.


**Si ka formësuar bashkëpunimi juaj në fushën e provës qasjen ndaj zbatimit të sanksioneve alternative në Maqedoninë e Veriut? Cilat janë ndryshimet që keni parë ju si rezultat i kësaj pune të vazhdueshme?**

Ekspertët nga sistemi i provës nga Republika e Kroacisë, gjykatësit nga Shkupi dhe drejtori i DES ndanë disa shembuj praktikë dhe shfaqën entuziazëm për përfitimet dhe rezultatet e arritura nga masat alternative. Broshura “Prova – Mjet i fuqishëm në sistemin penal-juridik” iu nda grupit të pjesëmarrësve. DES vuri re ndikimin pozitiv nga diskutimi: Zyra e provës në Manastir për herë të marrë pranoi kërkesa nga gjykata për përgatitje të dy vlerësimeve të rreziqeve për persona të akuzuar gjatë procedurave gjyqësore. Në përgjithësi, numri i rasteve të provës ka shënuar rritje të vogël prej dy përqind (474 në 2022 në 483 në 2023).

**Duke qenë se të drejtat e njeriut janë në thelb të këtij projekti, si koordinoheni ju me Komponentet e tjera?**

Të drejtat e njeriut dhe parandalimi i korrupsionit lidhen me njëra tjetrën, ngaqë korrupsioni pengon mekanizmat që mbrojnë të drejtat (e njeriut) dhe mund të shkaktojnë pabarazi dhe keqpërdorime.

Bashkë me Komponentin 3, ofrojmë trajnime për komunikim për përfaqësuesit e institucioneve të pavarura si KPMD, PP, Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK), dhe Agjencia për Mbrojtje të së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionin Publik (AMDQLIP), që iu mundëson atyre të njihen me njëri tetrin, të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë strategji të përbashkëta që do u ndihmojnë gjatë punës së përditshme. Ekspertët e komponentit tonë kanë dhënë komentet e tyre për Strategjinë Nacionale për Krimin Kibernetik dhe për Planin e Veprimit që është përgatitur brenda Komponentit 2. Kemi rekomanduar që të zgjerohet lista e formave të dhunës që mund të shfaqen online (p.sh. dhuna me baza gjinore) si dhe të përfshihen masa edukimi dhe parandalimi të çdo lloji dhune që mund të ndodhë online dhe që ka për qëllim fëmijët. Ky lloj dhune mund të ndikojë negativisht në shëndetin mendor, normalizon diskriminimin dhe përjashtimin, dhe nxit dhunën fizike ndaj njerëzve në gjendje të ndjeshme.



NËNTOR 2024 – SHKURT 2025

# KALENDARI NGJARJET E ARDHSHME

15 NËNTOR

**Tavolinë e rrumbullakët për diskutim të propozim-ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Këshillin Gjyqësor**

**Komponenti 1**

12 NËNTOR 14 NËNTOR

**Vizitë studimi - Sllloveni**

Përpilimi i Analizës për Operacionet e Fshehta dhe Zbulimin e Krimit

**Komponenti 2**

19 NËNTOR 20 NËNTOR

**Konferenca e Gjyqësorit:** Forcimi i llogaridhënies së gjyqësorit, pavarësia dhe besimi publik

**Komponenti 1**

04 DHJETOR

**Forumi i të Drejtave të Njeriut**

**Komponenti 4**

08 NËNTOR

**Takim pas pune për anti-korrupsion**

**Komponenti 3**






# Duke kapur suksesin:

## Një festim vizual










**IMPRINT**
**Botues:** Ludwig Boltzmann Gesellschaft – Instituti i tw Drejtave Themelore dhe tw Drejtave të Njeriut (LBI-GMR), Vienë, në kuadër të Projektit "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit", Shkup
**Redaktore:** Kristina Vesikj
**Lektura:** Ane Petrushevska
**Përkthyese:** Edona Vinca
**Periudha e raportimit:** 8 gusht – 7 nëntor
**Data:** 18 nëntor 2024

Financuar nga Bashkimi Evropian